

Zhvillimi Industrial

1. Zhvillimi Industrial në Shqipëri

Para luftës së dytë botërore, Shqipëria kishte një zhvillim industrial modest të përfaqësuar në shumicën më të madhe nga disa punishte që ishin më shumë të karakterit artizanal dhe vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre mund të konsideroheshin si industri e mirëfilltë.

Me fillimin e luftës dhe pushtimin e Shqipërisë nga Italia numri i këtyre fabrikave u shtua, dukuri kjo që përkon edhe me një zhvillim diskret ekonomik që njohu Shqipëria në atë periudhë. U zhvilluan kryesisht industritë nxjerrëse dhe përpunuese të lëndëve të para dhe minerale, sektori i ndërtimit dhe industritë e prodhimit të materialeve të ndërtimit.

Pas luftës, me ardhjen në pushtet të regjimit komunist vendi u drejtua drejt një ekonomie të centralizuar, të kontrolluar, të drejtuar dhe të planifikuar nga shteti me drejtim kryesor zhvillimin industrial dhe atë agrar të kolektivizuar. Në këtë periudhë filloi të marrë zhvillim industria e rëndë shqiptare e cila do të funksiononte jo mbi bazën e ekonomisë së tregut, por mbi baza politike.

Me rënien e sistemit komunist, në fillim të viteve 90-të, Shqipëria trashëgoi një industri absolutisht jo në gjendje që të konkurrojë në tregjet ndërkombëtare. Në këtë kohë filluan një sërë reformash të thella dhe të vrullshme ekonomike që synonin orientimin e ekonomisë shqiptare drejt ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë. Këto reforma bënë që industria e vjetër (me pak përjashtime), të zëvendësohej me ndërmarrjet e reja private që filluan të linden pas viteve 90-të.

2. Zhvillimi Industrial në Shkodër

Shkodra është rajoni me traditën më të pasur të zhvillimit industrial në Shqipëri. Ky zhvillim daton që në fillimet e shekullit të 20-të kur tregtarë të pasur shkodranë filluan të investonin në aktivitete industriale. Deri në vitin 1945 Shkodra ishte zona me zhvillimin më të lartë industrial në Shqipëri. Gjatë kësaj periudhe, sektorët më të zhvilluar ishin përpunimi i tekstileve dhe përpunimi agrorshqimor.

Pas vitit 1945 në frymën e zhvillimit industrial të drejtuar nga shteti, sektorë të tjerë u shtuan në industrinë e rajonit ku mund të përmenden përpunimi i drurit dhe prodhimi i kablo-telave nga uzina e telave Shkodër.

Pas ndryshimeve demokratike të viteve 90-të, një pjesë e madhe e industrisë në Shkodër doli menjëherë jashtë tregut meqënëse zhvillimi nuk ishte orientuar nga leverdishmëria ekonomike, por nga politika. Pas një periudhe apatie, kryesisht pas vitit 2000 filloi një fazë e re e zhvillimit industrial në Shkodër, e përqëndruar pothuajse ekskluzivisht në qytetin e Shkodrës. Aktualisht, ky zhvillim është përqëndruar në industrinë e përpunimit agrorshqimor, në industrinë e fasonit dhe në industrinë e përpunimit të drurit, sektorë ku rajoni mund të konkurrojë mirë në treg me traditën që ka dhe forcën punëtore të lirë dhe të kualifikuar. Në vitin 2008 në Shkodër numërohen 191 subjekte aktive në prodhim dhe 123 në industrinë e ndërtimit.

Industria në Shkodër është e përqëndruar kryesisht në Zonën Industriale të qytetit. Forca punëtore e lirë dhe e kualifikuar, kostot e ulëta të shërbimeve, infrastruktura e cila favorizon transportin dhe shkëmbimet dhe burokracia e reduktuar dhe politika qeveritare që mbron dhe nxit investimet e huaja, janë duke i dhënë një frymëmarrje të re zhvillimit industrial në Shkodër.

Pavarësisht se industria aktive në Shkodër është relativisht “e re”, shumë prej subjekteve janë konsoliduar, përdorin teknologji të avancuar dhe i eksportojnë produktet e tyre jashtë vendit. Këtu mund të përmendim disa subjekte të tilla si Bertoni, Cotonella, Adelchi (industria e fasonit), Meat Master (agrop ërpunim), Dafinor (përpunim druri), Progress Metal (përpunim metali), Arlecchino (prodhim maskash veneciane), etj.

Industria me indeksin më të lartë të zhvillimit, me teknologjinë më të përparuar, me numrin më të lartë të të punësuarve dhe me volumet më të mëdha të prodhimit e të eksportit është industria e fasonit. Aktualisht në Shkodër në këtë industri operojnë 22 subjekte aktive. Investimi në këtë industri është mjaft i favorshëm dhe për këtë arsye në pak vite kjo industri ka tërhequr mjaft investitorë vendas dhe të huaj.

3. Zona Industriale Shkodër

Fillimet e Zonës Industriale në Shkodër i përkasin vitit 1955. Deri në vitin 1990 ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm dhe ka kontribuar, për atë kohë, në ekonominë vendore dhe kombëtare. Pas viteve 90-të, si rezultat i reformave të thella ekonomike të vendit, si kalimi në ekonominë e tregut, njohja e pronës private dhe privatizimit, Zona Industriale pësoi ndryshime të mëdha strukturore, që u shoqëruan me mbylljen e shumë aktiviteteve ekonomike sidomos të industrise mekanike, të cilat nuk i rezistuan kushteve të reja të tregut.

Zona Industriale e Qytetit të Shkodrës mbetet një nga potencialet më të mëdha për zhvillimin e biznesit prodhues jo vetëm për qytetin, por për të gjithë rajonin e Shqipërisë Veriore. Ajo është zona me përqëndrimin më të lartë të bizneseve prodhuese, biznese që mbajnë peshën kryesore në punësim në sektorin privat dhe që përdorin teknologji të avancuar. Duke u mbështetur në dokumentet e planifikimeve strategjike, si dhe në bashkëpunimin me komunitetin e biznesit, Qeverinë Shqiptare dhe partnerët ndërkombëtarë, Zona Industriale përbën korpusin kryesor të zhvillimit ekonomik të qytetit. Kjo pasqyrohet qartë në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik 2005-2015 të qytetit të Shkodrës dhe strategjinë e Zhvillimit Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-2020.

Si rezultat i zbatimit të një sërë projektsh kryesisht të shërbimeve bazë infrastrukturore, kjo zonë ofron:

- Furnizim me energji elektrike pa ndërprerje gjatë 24 orëve në mënyrë të pavarur nga konsumatorët familjarë (është realizuar Ndërtimi i Linjës 20 kw në zonën industriale Shkodër),
- Është rikonstruktuar pothuajse plotësisht rrjeti i brendshëm i sistemit rrugor duke siguruar një akses shumë të mirë me rrjetin rrugor kombëtar,
- Siguron furnizim pa ndërprerje me ujë të pijshëm gjatë 24 orëve.

Rivitalizimi i Zonës Industriale vetëm me përmirësimin e shërbimeve bazë është një proces jo i plotë. Për të qenë të suksesshëm, ai kërkon zbatimin e koncepteve menaxhuese bashkëkohore. Hapat e parë tashmë kanë filluar të hidhen. Në vitin 2007 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për rivitalizimin e Zonës Industriale mes Bashkisë Shkodër dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, mbështetur nga GTZ. Një produkt i këtij bashkëpunimi është edhe vendimi i pak kohëve më parë i Këshillit të Ministrave për shpalljen e Zonës Industriale të Shkodrës, Zonë ekonomike: Park Industrial për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike me sipërfaqe totale 137 ha. Nga ana e Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme është ndërtuar database i pronësisë së të gjithë zonës. Gjithashtu, është hartuar një dokument paraprak i konceptit të zhvillimit të saj. Është parashikuar që zhvillimi i pronës publike të bëhet në mënyrë harmonike dhe të integruar me zhvillimin e pronës private. Përfshirja në proces e pronarëve privatë është shumë e rëndësishme, me qëllim që të eliminohet fragmentarizimi i skajshëm i pronave. Synimi final i këtij procesi është krijimi i tregut të tokës dhe ndërtesave të zonës industriale.

Masa të tjera të parashikuara për t'u marrë në të ardhmen për të gjallëruar zonën industriale përfshijnë:

- Ngritjen e një inventari trojesh të zonës industriale me ndërtimet (dhe gjendjen e tyre) dhe lidhjet aktuale me rrjetet e infrastrukturës (rrugët, rrjeti i energjisë elektrike me të dhënat mbi furnizimin, ujësjellësi, kanalizimi i ujërave të zeza)
- Matjet e trojeve të përzgjedhura me gurë kufizues të fiksuar në tokë.
- Dokumentimin e trojeve të regjistruara (inventarizuara) në një katalog
- Hapjen e një faqeje interneti për promovimin e zonës industriale (ndër të tjera edhe katalogu i trojeve të inventarizuara)
- Rehabilitimin e ujësjellësit të zonës industriale me ujë industrial.
- Hartimin e një aplikimi për financim në Bashkimin Evropian për rigjallërimin e zonës industriale Shkodër.
- Forcimin e zyrës së zhvillim koordinimit; ndër të tjera me ngritjen e një komponenti "Nxitja e zhvillimit ekonomik lokal"
- Fushatën e promovimit të zonës industriale Shkodër.

Problemet dhe vështirësitë aktuale për zhvillimin e zonës industriale lidhen kryesisht me pronësinë mbi tokën, copëzimin e territorit dhe ndërtimet pa leje.

4. Zona Industriale Koplík

Zona Industriale e Koplíkut – Një projekt i së ardhmes

Shoqata e Sipërmarrësve Italianë që Operojnë në Shqipëri (AlIOA) ka realizuar një projekt ambicioz, por të realizueshëm, me të cilin synon të zotërojë, e vetme ose në bashkëpronësi me qeverinë Shqiptare një zonë prej 70 ha në veri të Shkodrës, në brendësi të së cilës të realizojë një zonë të vërtetë industriale tërësisht të dedikuar sipërmarrësve që operojnë në Shqipëri. Kjo zonë industriale do të ketë në brendësi të saj hapësira të destinuar për: aktivitet prodhues, zyra dhe shërbime (studio profesionale, banka, sigurime, agjensi, dogana etj), shërbime mjekësore (roje mjekësore, ndërhyrje e shpejtë, mjekësi e punës), zona të dedikuara për trajnim, shoqërim etj.

Objektivi i projektit është ndërtimi i një zone industriale të orientuar në rregullimin e sipërmarrjeve italiane, ndërkombëtare dhe operatorëve lokalë, veçanërisht në

sektorin e prodhimit agro-industrial, agro-mekanik, industrisë së tekstilit etj. Presidenti i AIIOA në bashkëpunim me Ambasadën Italiane në Shqipëri, në marrëveshje me qeverinë shqiptare, marrëveshje që është ndjekur nga një konsultim me ekspertë të zhvillimit urbanistik dhe politikave ekonomike të qeverisë, ka konkretizuar propozimin duke prezantuar planin urbanistik të Zonës Industriale të Koplikut.

Zona Industriale e Koplikut – zhvillimi dhe planimetria

AIIAO, mbështetur nga qeveria shqiptare dhe ambasada Italiane në Tiranë, tenton të realizojë një zonë të përbërë industriale në territorin e Koplikut (bashki e vogël e pozicionuar në gjysëm të rrugës mes qytetit të Shkodrës dhe kufirit me Malin e Zi). Zona e ndërhyrjes shtrihet në rreth 64 ha, vendosur në Koplik dhe karakterizohet nga një formë planimetrike jo e rregullt. Plani parashikon tri pika hyrjeje përgjatë autostradës E762, drejtuese primare për në Malin e Zi që përbën një aks strategjik si për pikë të mundshme drejtimi ashtu dhe treg furnizimi. Afërsia me kufirin ka shtyrë në parashikimin e platformave për shërbime logjistike dhe periodike (zyra, parking për TIR), natyrisht për të nxitur dhe rregulluar lëvizjen e mallrave jashtë Shqipërisë. Përveç blloqeve për zhvillimin e strukturave industriale dhe infrastrukturës ndihmëse, ky projekt kompleks parashikon edhe ndërtimin e ambienteve dhe faciliteteve ndihmëse dhe rekreative të tilla si hotel, restorant, ishull i gjelbër, teatër i hapur, shatërvan, etj. Me përfundimin e këtij projekti, zona industriale e Koplikut do të jetë zona më e zhvilluar, më moderne dhe më e kompletuar në Shqipëri.

5 arsye për të investuar me aktivitete industriale në Rajonin e Shkodrës

1. Rajon në evoluim të fortë, me një ekonomi shumë aktive dhe me tregje interesante ende të pambuluar. Rajon me lidhje të ngushta historike me Italinë dhe Europën Perëndimore.
2. Pozicion i favorshëm gjeografik. Avantazhi i parë i territorit është afërsia me Italinë. Falë pozicionit gjeografik, Shkodra mbart shumë avantazhe për lokalizimin e proceseve produktive, si bazë ose urë për gjithë zonën ballkanike, nga Mali i Zi në Maqedoni e nga Serbia në Kosovë. Lidhjet me Italinë si tokësore ashtu dhe ujore mund të garantojnë një fluks të shpejtë personash dhe mallrash.
3. Ekzistenca e burimeve natyrore. Në rajonin e Shkodrës ekzistojnë shumë burime minerale që prezantohen me një shtrirje të konsiderueshme, cilësore dhe pak të shfrytëzuara. Këtu mund të përmendim argjilën, e vendosur në sasi të mëdha vetëm 8 km larg qytetit.
4. Burime njerëzore të kualifikuara dhe të lira. Rajoni i Shkodrës ka qenë historikisht zona më e shquar për artizanat në Shqipëri dhe një nga qendrat më të mëdha të shkëmbimit të produkteve të artizanatit në gjithë Ballkanin. Paga mesatare në Rajonin e Shkodrës është shumë e reduktuar, ndër më të ulëtat në Shqipëri dhe Europë. Disponibiliteti i fuqisë punëtore është shumë i dukshëm. Në Shkodër ndodhet Universiteti i vetëm i veriut të Shqipërisë me rreth 10000 studentë e me më shumë se 1000 të diplomuar në vit. Element për tu konsideruar është dhe njohja e gjuhës italiane nga moshat e reja dhe të mesme të popullatës dhe në përgjithësi aftësitë shumë të mira në zotërimin dhe komunikimin në gjuhë të huaja.

5. Infrastruktura dhe klima e biznesit në zhvillim të shpejtë. Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë CEFTA me vendet e rajonit si dhe Marrëveshjen Interim në kuadër të MSA e cila parashikon liberalizimin e plotë të tregtisë me BE për një periudhë 5-vjeçare. Eksportet shqiptare aktualisht kanë një trajtim më preferencial sesa importet nga BE. Sistemi bankar në përgjithësi në Shqipëri ka një zhvillim të mirë në krahasim me vendet e rajonit dhe në Shkodër operojnë aktualisht 11 banka të nivelit të dytë dhe 8 kompani sigurimesh.